
**AKT THEMELIMI
I shoqerise me perjegjesi te kufizuar
“M.A.G PARTNERS” SH.P.K.**

Ne Tirane sot me daten 24.02.2021 (dy mijë e njezete e nje) shtetasit: Z.GENTIAN ELEZI, i biri i ZENEL lindur me 12.12.1989 ne KUÇOVE dhe banues ne: Njesia bashkiake nr. 6 “Fabrika e qelqit” 268 Tirane, madhor dhe me zotesi te pote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr . BE0998777.

Neni 1

Personi i siperpermendur, me vullnetin e tij te lire dhe te pote dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi,vendosi te krijoje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin **“M.A.G PARTNERS” SH.P.K.** me kapital themeltar 10.000 leke (Pesembedhjetë mijë Leke)

Shoqeria ka seline e saj ne adresen: Njesia bashkiake nr. 6 “Fabrika e qelqit” 268, nr pasurie 426/108-G3.

Me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, Shoqeria mund te cele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Republikes se Shqiperise, gjithashu shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise apo edhe jashte tij.

Neni 2

Kompania gezon statusin e personit juridik.

Aktivitetet e saj do te kryhen sipas dispozitave te ketij akti, statutit dhe legjislacionit aktual. Statuti i kompanise eshte i bashkelidhur ketij akti te themelimit dhe formon nje pjese integrale me te.

Neni 3

Veprimtaria e kompanise si nje entitet juridik fillon me miratimin e krijimit te saj nga ana e organeve kompetente te shtetit dhe do te jete e vlefshme per nje periudhe te pacaktuar kohe. Shoqeria perfundon aktivitetet e veta me vendimarrje unanime nga te asambleja e ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj konform objektit qe do te jete:

Projektim, mbikqyrje dhe kolaudim i punimeve te ndertimit si: Rikonstruksion godinash civile, industriale dhe ekonomike, veshje fasadash, hidroizolime termoizolime. Montim dhe instalim, impianteve elektrik, impianteve hidraulik dhe termik, impianteve te avullit. Montimi dhe instalimi i linjave dhe pajisjeve ne fabrikat e industrise se rende edhe ne ate ushqimore. Punime germimi ne toke. Ndertime civile dhe industriale. Ndertim rruge, autostrada, mbikalime, impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut, sinjalistika rrugore jo ndricuese , barriera dhe mbrojtje rrugore , hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. Punime nentokesore, ura e vepra arti. Ndertim ujesjellesa, kanalizime, gazsjellesa, vajsellesa, veprakullimi e vaditje. Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. Ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise. Zbatime projekte dhe punime elektrike per rryma te dobeta dhe te tensionit te larte.Punime per prishjen e ndertimeve. Impiante hidro-sanitare,

kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre. Impiante ngrite se dhe transportues (ashensore, shkalle levizese, transportues). Punime rifiniture te muratureve dhe te lindhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese. Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri. Impiante teknologjik, termike dhe te kondicionimit. Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni, Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj. Punime topogjeodezike.

Neni 5 **Kapitali Themeltar**

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 10.000 leke (dhjete mijte Leke). Formuar dhe nenshkruar nga ortaku i vetem i shoqerise i barabarte me 1 Kuota me vlore nominale 1 kuote /10.000 leke i depozituar sipas ligjit dhe perkatesisht i ndare ne pjese te Kaptialit si me poshte:

Z.GENTIAN ELEZI, i biri i ZENEL lindur me 12.12.1989 ne KUÇOVE dhe banues ne: Njesia bashkiake nr. 6 "Fabrika e qelqit" 268 Tirane, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. BE0998777 zoteron 100 % te kuotave te kapitalit themeltar.

Ortaku i vetem ka te drejta pronesie mbi cdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter te fituar ne rruge te ligjshme, Shoqeria per gjigjet vetem me kapitalin e saj.

Neni 6

Shoqeria do te kete Administrator te saj Z.GENTIAN ELEZI
Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve.

Administratori ka te drejte te caktoje nje apo me shume perfaquesues te tij qe te mund te kryejne deri te njejtat funksione si administratori pa asnje limit, me prokure apo me autorizim, sipas ligjit.

Neni 7

Shoqeria cel llogari bankare ne monedhe Shqipetare dhe cdo lloj valute ne banka vendase apo te huaja private apo shteterore me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financier te aktivitetit te saj. Ortaku i vetem i shoqerise ose Administratori i emeruar prej tyre depozitojne faksimilet e firmave te tyre originale ne bankat ku eshte celur llogaria bankare .

Neni 8

Ortaku i vetem ka te drejte te transferoje jashte teritorit te Republikes se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e tij perfshire dhe fondet dhe kontributet e pjeseve te kapitalit themeltar .transferimet duhet te jene te vertetuara me akt notarial dhe per nje te tille duhet te mare paraprakisht vendim me shkrim nga Asambleja e Ortakeve .

Neni 9

Me vendim te ortakut te vetem shoqeria mund te zgjeroje aktivitetin e saj dhe ne drejtimet te tjera te cilat jane ne interes per mbarevajtjen e shoqerise.

Neni 10

Me vendim te Ortakut te vetem Shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere si brenda dhe jashte saj.

Neni 11

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi me i larte drejtues dhe Vendimor i Shoqerise dhe ai ushtron te gjitha kopetencat qe ligji per Shoqerite Tregetare i njeh Asamblese se Ortakeve qe jane krijuar me ortakeri .

Ortaku i vetem mund tja delegoje kopetencat nje ose me shume administratoreve te caktuar prej tij ose dhe nje personi fizik jashte shoqerise vetem mbi bazen e prokures.

Neni 12

Administratori i shoqerise "**M.A.G PARTNERS**" shpk eshte **Z.GENTIAN ELEZI** , ne cilesine e ortakut te vetem i biri i ZENEL lindur me 12.12.1989 ne KUÇOVE, me shtetesi Shqiptar, mbajtes i pasaportes me nr. BE0998777, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar:

Afati i emerimit te administratorit eshte 5(pesë) vjet .

Neni 13

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlera te njejtajuridike .

Emri dhe nenshkrimi i Ortakut Themelues:

**ORTAKU THEMELUES
Z. GENTIAN ELEZI**

